

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE "R.E.R CONSTRUCTION" SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe atij nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", me vullnetin tone te lire, ne,

1. Elvis Sejati, i biri i Agimit i date lindjes 15.07.1979, me karte identiteti ID me nr. personal H90715065K, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar
2. Redin Nallbani, i biri i Shabanit i date lindjes 26.05.1970 me karte identiteti ID me nr. personal H00526040T, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar shpallim si vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "R.E.R CONSTRUCTION" sh.p.k me ortake themelues: Elvis Sejati dhe Redin Nallbani.

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne qytetin e Tiranës, Njesia Bashkiake Nr. 6, Rruga "Hysni Rusi", ish Fabrika e Silikateve, Godina nr 14, Tirane. Ajo mund te çele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar.

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jete:

1. Import-eksport dhe tregti te mallrave te ndryshme industriale, artizanatit, artistike etj, te te gjitha llojeve.
2. Tregti , import-export , prodhim , perpunim e sherbime ne fushen e industrise ushqimore , materialeve te ndertimit,te industrise , artizanatit , farmaceutike , artistike etj.
3. Projekte inxhinerike per linjat e perpunimit industrial, kerkime dhe studime te ndryshme ne fushen e fizibilitetit per zbatimin e projekteve te ndryshme dhe asaj te marketingut.
4. Veprimtari ne tregti me pakice te mallrave te ndryshme industriale, artizanatit, artistike etj, te te gjitha llojeve dhe sherbime.
5. Kryerja e sherbimeve te ndertimit, rikonstruksionit dhe te tjera aktivite ne fushen e ndertimit.

NENI 6


Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000.000 (dhjete milion) leke dhe perbehet nga 2 kuota me vlere nominale 5.000.000 Leke secila. Kuotat do te shlyhen teresisht ne vleren nominale te tyre brenda tre viteve nga data e regjistrimit ne QKB.

Kuotat jane te numeruara nga 1 deri 2.

Ortaket e shoqerise jane:

1. Elvis Sejati, i biri i Agimit i date lindjes 15.07.1979, me karte identiteti ID me nr. personal H90715065K i cili zoteron 50 % te Kuotave ne kapitalin themeltar te shoqerise. Githsej 1 Kuote me vlere 5.000.000 lek/Kuote, gjithsej 5.000.000 leke
2. Redin Nallbani, i biri i Shabanit i date lindjes 26.05.1970 me karte identiteti ID me nr. personal H00526040T, i cila zoteron 50 % te Kuotave ne kapitalin themeltar te shoqerise. Githsej 1 Kuote, me vlere 5.000.000 lek/Kuote, gjithsej 5.000.000 leke

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe do te shlyhen krejtësisht per tre vjet. Ndryshimi i kuotave behet nepermjet kontributeve ne kapital ose me shitblerje.



NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakut(eve), por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortaku mund te shesin te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakut(eve) me 100% te votave.

NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj.

NENI 10

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

NENI 11

Administrator i shoqerise "R.E.R CONSTRUCTION" shpk emrohet Zoti. Nikolas Prenga, me afat 1 vit.

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transakcioneve financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise. Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim te ortakeve, mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i rezerves ligjore.

NENI 14


Ky akt u perpilua ne prani te ortakeve duke shprehur vullnetin e tij te plote e te lire.

Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

Tirane me 25.10.2021

ORTAKET THEMELUES

Elvis Sejati

Elvis Sejati


Redin Nallbani

Redin Nallbani
